



*Tiranë, më 25.10.2017*

## **N J O F T I M**

Mbështetur në Vendimin e Rektoratit me Nr.155, datë 25.10.2017 “Për pranimin e personelit akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2017 – 2018 ne Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes”, njoftohen të gjithë kandidatët e interesuar që duan të aplikojnë për personel akademik me kohë të pjesshme (pedagog të jashtëm), në Departamentin e Shkencave Sociale dhe të Edukimit, FSHL që duke filluar nga data 25.10.2017 deri më 01.11.2017, duhet të dërgojnë më anë të shërbimit postar në Protokollin e Universitetit të Sporteve të Tiranës dokumentacionin përkatës.

- Curriculum Vitae (e detyrueshme).
- Diplomën dhe Certifikatën e notave të studimeve Bachelor (fotokopje) (e detyrueshme)
- Diplomë dhe Certifikatën e notave të studimeve Master i Shkencave ose DIND (fotokopje) (e detyrueshme)
- Certifikatën e gradës Doktor i Shkencave (fotokopje)
- Dëshminë e titullit Profesor i Asociuar (nqs ka) (fotokopje)
- Dëshminë e titullit Profesor (nqs ka) (fotokopje)
- Fusha e studimit dhe diplomimit duhet të përputhet me lëndën mësimore që do të zhvillojnë sipas Departamentit ku aplikon.
- Preferohen pedagogët që kanë përvojë në mësimdhëni në shkollën e lartë.
- Të zotërojnë një gjuhë të huaj (preferohet gjuha angleze).
- Të ketë njohuri për njohjen e programeve bazë kompjuterike
- Të vërtetojë që nuk është i dënuar penalisht (vetëdeklarim) (e detyrueshme)
- Fotokopje të kartës së identitetit (fotokopje) (e detyrueshme)
- Numrin e llogarisë bankare. (nqs ka)
- Vërtetim nga qendra e punës për t’u angazhuar si pedagog me kohë të pjesshme në institucionin tonë. (nqs është i punësuar) (e detyrueshme) si dhe leja nga titullari i institucionit ku punon.
- Librezë shëndetësore nga Drejtoria e Shëndetit Publik (dorëzohet nëse shpallet fitues)

### **Departamenti i Shkencave Sociale dhe të Edukimit**

- |                                             |                                                 |
|---------------------------------------------|-------------------------------------------------|
| 1. Menaxhim i Marketingut të Sportit (Bach) | 1(një) Lektor, (me gradë shkencore ose titull)  |
| 2. Psikologji Zhvillimi (Master Profes.)    | 1 (një) Lektor, (me gradë shkencore ose titull) |

Vetem paketat e aplikimit të mbërritura me anë të shërbimit postar pranohen dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të kandidatëve.

Në zarf duhet të shënohet adresa e sakte e aplikimit, Universiteti i Sporteve të Tiranës, Fakulteti ku konkuron, Departamenti, emri, mbiemri, Nr. telefonit dhe e-mail të konkurentit.

**Prof. Dr. Agron CUKA**

**R E K T O R**